

Shaqir Salihu rrëfen jetën, veprimtarinë dhe kontributin e tij për Kosovën në emisionin 'Fakte'

Ish-gazetari i Zërit të Amerikës flet për burgosjet, emigrimin në SHBA, diasporën shqiptare dhe rolin e Amerikës në çlirimin e Kosovës.

PRISTINA, PRISHTINË, KOSOVO, July 13, 2026 /EINPresswire.com/ -- Ish-gazetari i Zërit të Amerikës flet për burgosjen nga regjimi jugosllav, emigrimin në Shtetet e Bashkuara, organizimin e diasporës shqiptare dhe rolin vendimtar të Amerikës në çlirimin e Kosovës



Adnan Merovci interviston Shaqir Salihun për jetën, veprimtarinë dhe kontributin e tij për Kosovën.

Veprimtari, gazetari dhe ish-redaktori shumëvjeçar i Shërbimit Shqip të Zërit të Amerikës, Shaqir Salihu, ishte mysafiri kryesor në një intervistë të veçantë në emisionin [“Fakte” me Adnan Merovcin](#).

“

Zëri i Amerikës nuk ishte vetëm një vend pune. Ishte një institucion që u jepte shqiptarëve lajme dhe të vërteta që nuk mund t'i dëgjonin nga mediat e kontrolluara në Shqipëri dhe Jugosllavi.”

Shaqir Salihu

Gjatë bisedës, Salihu rrëfeu jetën e tij, duke filluar nga fëmijëria në Banullë të Lipjanit, vitet e para si mësues, përndjekja nga regjimi jugosllav, burgosja për shkak të veprimtarisë së tij kombëtare shqiptare dhe arratisja nga Jugosllavia.

Intervista e plotë është e disponueshme në YouTube: <https://www.youtube.com/watch?v=iPIKnqkWkM8>

Intervista trajton gjithashtu emigrimin e tij në Shtetet e Bashkuara në vitin 1970 dhe fillimin e një jete të re si

refugjat politik. Salihu foli për vështirësitë e para të emigrimit, vendosjen në Uashington dhe rrugëtimin që e çoi drejt një karriere 32-vjeçare në Zërin e Amerikës.

"Zëri i Amerikës" nuk ishte vetëm një vend pune. Ishte një institucion që u jepte shqiptarëve lajme dhe të vërteta që nuk mund t'i dëgjonin nga mediat e kontrolluara në Shqipëri dhe Jugosllavi", thekson Salihu gjatë intervistës.

Ai kujtoi rolin e Zërit të Amerikës në raportimin për demonstratat, burgosjen dhe vrasjen e shqiptarëve, diskriminimin në Kosovë dhe shpërbërjen e Jugosllavisë. Salihu foli gjithashtu për sfidat e raportimit mbi Kosovën gjatë një periudhe kur disa zyrtarë amerikanë ende e konsideronin Jugosllavinë një aleat të rëndësishme.

Një pjesë e rëndësishme e intervistës i kushtohet angazhimit të tij në komunitetin shqiptaro-amerikan. Ky angazhim përfshinte sigurimin e lejeve për demonstratat shqiptare në Uashington, të cilat zhvilloheshin para Kongresit, Shtëpisë së Bardhë dhe Ambasadës së Jugosllavisë.

Ndiqueni intervistën e plotë në YouTube:

<https://www.youtube.com/watch?v=iPIKnqkWkM8>

Sipas tij, këto protesta dhe takimet e vazhdueshme të komunitetit me senatorë, anëtarë të Kongresit dhe zyrtarë amerikanë ndihmuan në ndërgjegjësimin e opinionit amerikan për gjendjen e shqiptarëve në Kosovë dhe në trojet e tjera të banuara me shqiptarë në ish-Jugosllavi.

Salihu foli gjithashtu për vizitat e para të Ibrahim Rugovës në Shtetet e Bashkuara dhe për ndikimin që mesazhi i tij paqësor dhe demokratik pati në Uashington.

Ai e përshkroi Rugovën si një udhëheqës që fliste shkurt, por fjalët e të cilit kishin peshë dhe domethënie të madhe. Sipas Salihut, Rugova luajti rol vendimtar në ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës dhe në krijimin e lidhjeve të forta me institucionet amerikane.



Shaqir Salihu



Shaqir Salihu në një bashkëbisedim të veçantë me Adnan Merovcin në emisionin "Fakte".

Një nga momentet më emocionale të intervistës ishte rrëfimi i Salihut për 24 marsin 1999, ditën kur NATO filloi fushatën e bombardimeve kundër forcave jugosllave.

Salihu kujtoi atmosferën në redaksinë e Zërit të Amerikës dhe pritjen e deklaratës së presidentit Bill Clinton. Ai tha se fillimi i ndërhyrjes së NATO-s ishte një nga momentet më të lumtura dhe më emocionuese të jetës së tij.

[Intervista përfshin gjithashtu](#) historinë e një kravate të veçantë që kishte qenë pronë e Mid'hat Frashërit dhe që më vonë iu dhurua Shaqir Salihut për shkak të përkushtimit të tij ndaj çështjes kombëtare shqiptare.

Salihu e vesh kravatën vetëm në raste të veçanta, përfshirë Ditën e Flamurit, përvjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë dhe Ditën e Pavarësisë së Kosovës.

Në pjesën përfundimtare të intervistës, Salihu foli për marrëdhëniet aktuale mes Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara. Ai paralajmëroi se Kosova nuk ka luksin të rrezikojë marrëdhënien me aleatin e saj më të rëndësishëm.

“Heshtja e mikut nuk është gjithmonë e këndshme”, tha Salihu, duke bërë thirrje për bashkëpunim politik, institucione funksionale dhe ruajtjen e partneritetit strategjik me Shtetet e Bashkuara.

Pas pensionimit nga Zëri i Amerikës në vitin 2012, Shaqir Salihu vazhdoi punën e tij si autor dhe kronikan i historisë së Kosovës. Në librin e tij “Rrëfime lirie”, ai përshkruan rrugëtimin nga burgjet jugosllave deri te Zëri i Amerikës.

Ai ka punuar gjithashtu në dokumentimin e konferencave për shtyp dhe komunikimit publik të presidentit Ibrahim Rugova nga viti 1990 deri më 1999, një projekt që kërkoi më shumë se një dekadë punë.

Intervista e plotë me Shaqir Salihun është e disponueshme në kanalin YouTube të emisionit “Fakte” me Adnan Merovcin:

<https://www.youtube.com/watch?v=iPIKnqkWkM8>

Rreth Shaqir Salihut

Shaqir Salihu është veprimtar, gazetar dhe autor shqiptaro-amerikan. Ai lindi në vitin 1942 në Banullë të Lipjanit dhe filloi karrierën si mësues. Për shkak të veprimtarisë së tij kombëtare shqiptare, u arrestua dhe u burgos nga autoritetet jugosllave.

Në vitin 1970, ai emigroi në Shtetet e Bashkuara si refugjat politik. Nga viti 1980 deri në pensionimin e tij në vitin 2012, punoi në Shërbimin Shqip të Zërit të Amerikës në Uashington.

ShaqirSalihu.com

ShaqirSalihu.com

[email us here](#)

Visit us on social media:

[Facebook](#)

[YouTube](#)

[X](#)

This press release can be viewed online at: <https://www.einpresswire.com/article/926215182>

EIN Presswire's priority is source transparency. We do not allow opaque clients, and our editors try to be careful about weeding out false and misleading content. As a user, if you see something we have missed, please do bring it to our attention. Your help is welcome. EIN Presswire, Everyone's Internet News Presswire™, tries to define some of the boundaries that are reasonable in today's world. Please see our Editorial Guidelines for more information.

© 1995-2026 Newsmatics Inc. All Right Reserved.